

SHOQERIA TREGTARE
Me pergjegjesi të kufizuar

"Luxury Garage Auto" shpk.
FIER

AKT THEMELIMI

Ne FIER, sot me daten 06/01/2025 une i nenshkruari :

1-Ermir Muço, datelindja 08/08/1979, lindur dhe banues ne Fier, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me nr personal H90808071W

Me Vullnet të lire të plote , dhe inisiativen e lire private, mbeshetur :
Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne baze te Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare" dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 me ndryshimet " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit "
krijojme shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar,
"Luxury Garage Auto" shpk Fier, Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga 1 ortak i vetem i sipercituar, me emrin **"Luxury Garage Auto"** shpk Fier, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise **"Luxury Garage Auto"** shpk eshte :
Fier,Lagja Sheq i madh Rruga Teodor i II Muzaka,godina nr 17.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen , seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqintmije) leke , formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem, vlere e cila do te shlyhet mbasi shoqeria te jete rregjistruar ne QKR dhe i perket ortakut si me poshte :



Z. Ermir Muço, zoterues i nje kuote me vlere 100.000 (njqindmije) lek,qe perben 100% te kapitalit themeltar

Shoqeria pergjigjet per humbjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtar.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjesisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille Asambleja e Ortakeve duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 8

Objekti i veprimtarise:


Import shit-blerje automjatesh dhe dhenia me qera e tyre.

NENI 9

Me vendim të Asamblese Ortakeve, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime të tjera të cilat jane me interes per mbarevajtjen e shoqerise.

NENI 10

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.



NENI 11

Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji “ Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare “ i njeh amblese se ortakeve . Asambleja e Ortakeve mund t’ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 12

Administrator I shoqerise “**Luxury Garage Auto** “ shpk, eshte
1-Ermir Muço, datelindja 08/08/1979, lindur dhe banues ne Fier, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me nr personal H90808071W

I Cili eshte i zgjedhur ne kete pozicion per nje periudhe jo me shume se pese vjet .

NENI 13

Ky akt themelimi u redaktua ne 1 kopje, e cila nenshkruhet prej ortakut ne cdo faqe .

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE

“**Luxury Garage Auto**“ SHPK

ERMIR MUÇO

